



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2018, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me drejtorin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglangtina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Benet Beci – Drejtor i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Ermira Musaraj –përfaqësuese e FSHZH-së

Ermir Omari – përfaqësues i FSHZH-së

Nikolin Lera –përfaqësues i Ministrisë së Financave

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, kolegë deputetë!

Vijojmë me axhendën e kësaj jave lidhur me diskutimin e projektbuxhetit për vitin 2019. Kemi një numër të konsiderueshëm dëgjësash për ditën e sotme.

Vazhdojmë me seancën dëgjimore me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Të ftuar kemi zotin Benet Beci, zonjën Ermira Musaraj dhe zotin Omari. Relator është zotin Besnik Baraj.

Në fillim dua t'ia jap fjalën drejtorit, zotit Benet Beci, pastaj vazhdojmë me pyetjet.

A jeni dakord me rendin e ditës? Dakord.

Zoti Beci, fjala për ju.

Benet Beci – Përshëndetje, kryetar!

Siç e keni edhe në materialet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, ka një buxhet në vijueshmëri të viteve të tjera, afërsisht në të njëjtën linjë buxhetore që kemi pasur edhe më parë, e cila është rreth 163 milionë dollarë.

Buxheti ndahet në disa komponentë. Pjesa kryesore e financimit të buxhetit përbëhet nga financimet e huaja, ku disa nga projektet i kemi paraqitur në komisionin tuaj, donatorë kryesorë të të cilave janë Banka Botërore, BERZH-i KfW-ja dhe BEI, si dhe disa projekte të financuara nga të huaj, që vijnë nga projekte të mëparshme të filluara në vitet e shkuara, të cilat do të vazhdojnë të realizohen gjatë këtij viti me Bankën e Këshillit të Europës.

Në pjesën kryesore të buxhetit të vitit të shkuar, financimet e huaja përfshijnë njëkohësisht edhe një financim të rëndësishëm, që është për lumin e Vlorës, ku janë të dy lotet e tjera në punë, financimi i Fondit të Zhvillimit Kuvajtian së bashku me Fondin e Arabisë Saudite. Kjo është pjesa e grupit të financimeve që vijnë nga donatorët e huaj, ku ne, herë pas here, i kemi kaluar në komisionin tuaj në mënyrë më specifike. Po kështu, nga fondet e buxhetit të qeverisë shqiptare ne po ndjekim një sërë projektesh, që janë të detajuara në materialet që keni përpara, në një vlerë prej 5,5 miliardë eurosh. Ajo që dua të them është se balanca mes fondeve që ne implementojmë të buxhetit të shtetit dhe fondeve të huaja vazhdon të mbetet në favor të projekteve të huaja, që ne kemi edhe si më të specializuar për implementimin e projekteve të huaj, por në të njëjtën fushë investimesh, ne vazhdojmë të investojmë fuqishëm edhe me fondin e qeverisë shqiptare, projekte të cilat janë drejtpërdrejt zhvillimore për infrastrukturën rurale dhe rajonale.

Llojet e financimeve të projekteve gjithmonë e më shumë po shkojnë drejt projekteve të integruara dhe të ndërhyrjes edhe me fondet e donatorëve edhe me qeverinë për

një planifikim më të integruar me një koncept të qartë të zhvillimit ekonomik të zonave ku ne ndërhyjmë.

Ne kemi edhe projekte me ndërkombëtarë, siç është ai turizmit me Bankën Botërore, ku përfshihet Gjirokastra, Saranda, Përmeti dhe Berati, i cili është një nga projektet më të integruar dhe multidimensional i lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik të turizmit si një element i zhvillimit ekonomik zonal. Kemi me CEB-in projektin në zonën e alpeve, ku kemi disa ndërhyrje në pjesën veriore. Po i përmend projektet sipas shpërndarjes gjeografike. Kemi projekte me qeverinë shqiptare në zonën e Shkodrës, në pjesën e Vlorës dhe në të gjithë bregdetin e Jugut, si një zonë prioritare për zhvillimin e turizmit. Kështu që shpërndarja gjeografike e projekteve është në të gjithë Shqipërinë dhe njëkohësisht diversifikimi i projekteve, që është një nga karakteristikat e reja të aktivitetit të fondit, pra jo vetëm infrastrukturë, por edhe zhvillimi ekonomik dhe përqasje shumë e integruar e investimeve tona, është një specifike dhe karakteristikë tjetër e buxhetit të këtij viti.

Më kënaqësi konstatoj se gjatë këtij viti, edhe gjatë viteve të kaluara, buxhetet kanë qenë shumë realiste dhe praktikisht mundohemi, dhe ia kemi arritur, që të realizojmë jo vetëm mirëplanifikimin, por edhe mirërealizimin e buxhetit ndër vite dhe mendojmë që të gjitha detyrat dhe objektivat që na jep ky buxhet të mund t'i realizojmë në cilësinë dhe kohën e duhur.

Për nga pjekuria institucionale që kemi marrë si institucion dhe për modelin e projekteve që po zhvillojmë dhe po ndërtojmë tani, unë besoj se ky buxhet do të sjellë një impakt shumë më eficient në zhvillimin ekonomik rajonal, për të cilin ne jemi përgjegjës si institucion.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Beci!

Fjalën e ka zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti Beci, për shpjegimin që bëtë për buxhetin!

Ne bashkë kemi pasur edhe kontakte të tjera pune dhe kemi bërë 2-3 vizita në institucionin tuaj dhe sinqerisht dua t'ju falënderoj për pritjen dhe disponibilitetin tuaj për të qenë korrekt dhe për të qenë afër me investimet, ku unë jam deputet.

Ajo që unë dua të di për projektin e rrugës së Lumit të Vlorës janë afatet e fillimit dhe përfundimit të punimeve për dy lotët e tjerë, nga Gjormi-ura e Laskës dhe nga ura e Laskës-Qeparo, si dhe për lotin e fundit, që është Peshkëpi-Selenicë dhe ura lidhëse me rrugën Levan-Tepelenë-Gjirokastrë –Kakavijë.

Në buxhetin tuaj shoh një pikë ku thuhet: “Hartimi i projekteve për rrugët rurale”, është parashikuar një shifër rreth 150 milionë. Dua t’ju kërkoj, brenda mundësive, që të hartimi i projekteve të rrugëve rurale, duke pasur parasysh se zona e Bashkisë së Selenicës dhe një pjesë e Bashkisë së Himarës, që ka të bëjë me lumin e Vlorës, është një zonë shumë malore, e cila ka nevojë për ta ndihmuar në zhvillimin e saj ekonomik, që brenda kësaj pike të shikoni mundësinë e projektimit të rrugës Vllahinë-Poçem, ku aty ndodhet një urë që e lidh zonën me rrugën Levan-Tepelenë- Gjirokastër-Greqi.

Një shqetësim tjetër në zonën time lidhet me disa fshatra që ndodhen në krahun tjetër të lumit dhe nuk kanë mundësi të lidhen me lumin e Vlorës, pasi urat me të cilat ato lidhen janë ura dërrase, pasarella, dhe nuk u japin mundësi banorëve të lëvizin me makina drejt rrugës kryesore. Unë mendoj se vlerat e rrugës së lumit të Vlorës do t’i rriteshin më tepër kur ne t’u krijojmë mundësinë edhe këtyre fshatrave, siç janë Vodica, Lapardhaja dhe Lepenica. Dua të di nëse ekziston mundësia për t’u dhënë mundësinë këtyre fshatrave për të pasur vërtet kënaqësinë e shfrytëzimit të kësaj vepre të qeverisë shqiptare me rrugën e lumit të Vlorës.

Benet Beci – Zoti Vullnet, faleminderit!

Për mua është kënaqësi. Ne kemi pasur një diskutim të hapur dhe unë gjej rastin të të falënderoj për mënyrën sesi jemi përqasur dhe kemi bashkëpunuar në funksion të realizimit të këtij projekti, që absolutisht është nga më të rëndësishmit që ne realizojmë në zonën e rajonit të Vlorës. Jo vetëm në rajon, por edhe në rang vendi, ky është një projekt realisht shumë me impakt të lartë dhe i rëndësishëm.

Po e filloj nga pika e dytë, ku ju e shikoni mënyrën sesi të integrojmë brenda këtij projekti dhe të maksimizojmë interesin dhe impaktin e projektit në rajon dhe në zonë. Është krejtësisht e vërtetë që pjesë e ndërlidhjes me disa nga akset që tashmë mund të lidhen me aksin kryesor mund ta maksimizonte interesin dhe efektivitetin e rrugës.

Siç jeni në dijeni, ne po e shikojmë lidhjen e aksit edhe me pjesën e Tepelenës, nga Gusmari, i cili është një akt tjetër që zbrit të gjithë pjesën e Tepelenës në zonën e lumit të Vlorës deri në Himarë. Njëkohësisht jemi shumë të predispozuar, por ndoshta në një fazë të dytë, që të shikojmë të gjitha lidhjet, siç ishte kjo që propozuat ju, të cilat mund t’i japin mundësi që rruga dhe aksi kryesor të marrë një përdorim më të lartë dhe të ketë impakt më të lartë në zonë.

Nuk mund të flas sot për propozimin që ju thatë, por marr përsipër që në analizën e rrugëve lidhëse në funksion të aksit kryesor, ne të shikojmë me seriozitet propozimet tuaja dhe shumë shpejt do t’u japim një përgjigje se sa mundësi kemi ne për t’u futur aty.

Për sa i përket pyetjes se si shkojnë punimet, ju e keni parë që punimet për segmentin e parë, bajpasi Peshkopi-Gjorm, ku ne po punojmë prej rreth 23 kilometrash, ka ecur mjaft mirë dhe ne shpresojmë që në pranverën e vitit tjetër të ketë përfunduar me të gjitha detajet. Rruga është e kalueshme pa tapetin, por me shtresat para tapetit, ku ka ndryshuar perceptimi dhe mundësia e transportit. Gjithsesi, ne do ta përfundojmë rrugën shumë shpejt në gjysmën e parë të vitit dhe shumë shpejt ne do të fillojmë me dy lotët e tjera, Gjorm-Brataj dhe Ura e Laskës-Qeparo. Ne po punojmë që të dyja lotet të fillojnë në të njëjtën kohë, në mënyrë që të kemi mundësi aksesimi në të dy akset. Është nënshkruar kontrata e supervizionit për rrugën Selenicë-Peshkëpi, e cila mendoj se fillon vitin që vjen.

Me buxhetin që kemi dhe me parashikimin e realizimit të financimit për viti tjetër, ku pjesa kryesore e pagesave do të bëhet në këtë vit, impakti do të jetë i dukshëm në të gjithë aksin e lumit të Vlorës.

Vullnet Sinaj – Atëherë, me besimin se ju do t'i ndiqni nga afër propozimet e mia, edhe një herë dua t'ju tërheq vëmendjen për rrugën Vllahin-Poçem, e cila është një urë lidhëse e zonës me aksin kryesor që të çon në Greqi.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Zoti Marto, fjala për ju!

Andrea Marto –Faleminderit, kryetar!

Unë kam dy pyetje. Së pari, sa për qind e buxhetit të vitit 2019 shërben për të financuar projektet ekzistuese dhe sa për qind për projektet e reja?

Së dyti, cilat janë procedurat e përzgjedhjes së projekteve?

Benet Beci – Për sa u përket procedurave, në rastet specifike, sipas projekteve, ne i kemi shpjeguar procedurat. Për shembull, për financimin e projekteve të turizmit nga Banka Botërore ka disa lloj procedurash në funksion të objektivit të përzgjedhjes, të qëllimit dhe të karakteristikave që ka. Cila është mënyra sesi ne përzgjedhim, përveç kërkesave të donatorëve dhe qeverisë shqiptare?! Ne kemi *database* që në funksion të objektivave të projektit të përzgjedhim në mënyrë të pikëzuar projekte, të cilat plotësojnë kërkesat e rënies dakord në një projekt donatorësh, ose në rastin e qeverisë, nëpërmjet bashkëpunimit me bashkinë dhe bërjes së një liste të gjatë me propozime, me kërkesa dhe pastaj një filtrim me pikë të projekteve, të cilat përmbushin më së miri ose kanë avantazhe në krahasim me të tjerat për të bërë një *short list*. Pra, kalohet nga një kërkesë e madhe në një të vogël. Kjo është në përgjithësi mënyra sesi përzgjedhim projektet, por që kanë specifika sipas karakteristikave

të projektit. Është gjithmonë një sistem, i ndërtuar prej kohësh në përzgjedhjen e projekteve, që mundohemi ta mbajmë në mënyrë korrekte.

Për sa i përket raportit të përqindjes së projekteve të reja, këtu ka një veçori. Programet që ne kemi kaluar janë programe, të cilat duan 3-4 vjet që të implementohen, ndoshta nuk mund të fillojnë këtë vit, sepse janë përgatitur dhe janë në proces e sipër. Gjatë programit ne kemi projekte në vazhdim, që në këtë moment nuk mund ta them se sa është numri, por përafërsisht janë 20-30% projekte të rinj, të cilat janë brenda programeve ekzistuese, por që do të fillojnë të implementohen gjatë këtij viti.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, drejtor!

Edhe unë dua t'ju përgëzoj dhe komplimentoj për punën që bëni, për fondet që merrni nga qeveria, por edhe për investimet e huaja për të realizuar këto projekte.

Eduard Shalsi- Meqenëse zonja Gjermani e përmendi, në ç'raport janë fondet e qeverisë shqiptare me ato të huaja?

Benet Beci – 1 me 3.

Eduard Shalsi – 1 nga qeveria shqiptare, 3 nga donatorët apo anasjelltas?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Gjermani, më fal, mund të vazhdoni!

Eglantina Gjermani – Meqenëse unë jam deputete e qarkut të Durrësit, në mënyrë të veçantë dua t'ju pyes për Bashkinë Krujë. Ne flasim shumë për zhvillimin e turizmit sezonal dhe për atë gjatë gjithë vitit, ndërkohë që Kruja ka një turizëm gjatë gjithë vitit dhe ka një numër të lartë turistësh rruga Fushë Krujë-Krujë është në gjendje të mjerueshme. A është parashikuar ose a ka ndonjë mundësi që kjo rrugë të bëhet, kjo në ndihmë të qytetarëve, por edhe të turistëve? Meqenëse ishte “Viti i Skënderbeut”, mendova se qyteti i Krujës do të kishte një vëmendje më të madhe.

Në mënyrë të veçantë dua të pyes për projektin e Alpeve, dua të di se ku është sot, çfarë po ndodh realisht dhe cili është impakti.

Faleminderit!

Benet Beci – Faleminderit!

Lidhur me qytetin e Krujës, në këtë moment ne kemi dy investime; ndërtimin e Urës së Zezë dhe mbrojtjen e qytetit nga përmbytjet e lumit Zezë. Praktikisht në këtë zonë po punojmë me rrugën Fushë Krujë-Thumanë, e cila ka filluar më parë dhe e mbarojmë këtë vit.

Lidhur me rrugën që ju thoni, ne nuk kemi një plan për të filluar. Nuk është e sigurt nëse është diçka që mund ta diskutojmë me ARSH-në, sepse është rrugë nacionale dhe në planet tona nuk është, por kemi këto 2-3 projektet e tjera për zonën e Krujës.

Eglantina Gjermeni – Lidhur me lumin Zezë, unë nuk e shikoj të parashikuar në buxhet.

Benet Beci - Është në projektet tona.

Eglantina Gjermeni – Ju falënderoj!

Benet Beci – Për sa i përket projektit të Alpeve, unë e falënderoj zonjën Gjermeni, sepse ne kemi pasur një bashkëpunim në atë kohë për përgatitjen e atij projekti, me konsideratat më të mira ndërkombëtare, i cili është një nga planet më të mira dhe studimet më të mira të bëra në një zonë të integruar, siç është pjesa e Alpeve, e cila është më sfiduesja për ne. Me Bankën e Këshillit të Europës dhe me qeverinë shqiptare ne kemi vazhduar të financojmë disa projekte në funksion të zhvillimit të Alpeve dhe për informacion ne kemi hyrë jo vetëm në pjesën e alpeve, por edhe në pjesën shoqëruese, siç mund të përmend projektet në Pukë dhe Ulëz, dy nga ndërhyrjet më të bukura, që ende nuk i keni parë, por që do të jenë ndërhyrje transformuese. Në Vermosh, Tamarë dhe Valbonë kemi ndërhyrje konkrete dhe kemi filluar punën. Për dijeninë tuaj, koncepti për ndërhyrje në zonën e Alpeve është një përjasje e re jo vetëm e integruar, por edhe shumë e koordinuar. E gjithë zona është parë me itinerare shumë të kombinuara turistike, ku në bazë të këtyre itinerareve është përcaktuar edhe mënyra e investimeve tona. Kështu që ne kemi një listë projektesh të parashikuara në funksion të studimit dhe të itinerareve turistike, që përfshijnë Valbonën, Tamarën, Vermoshin, shtigjet dhe pjesën e shesheve të ndërtuara ose 2-3 godina shumë interesante turistike në pjesën e Valbonës, si dhe ndryshimi komplet i Pukës në zonën malore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vlera e projektit është rreth 5 milionë euro. Kjo shumë është e gjitha e dedikuar për ndërhyrjet dhe në funksion të studimit të zonës së Alpeve.

Eduard Shalsi – Meqenëse jemi këtu, Thethi ka edhe segmentin e fundit.

Benet Beci – Faleminderit, zoti kryetar!

Ajo është në një program tjetër, por të gjitha programet ne mundohemi t'i koordinojmë, pavarësisht se na vijnë nga burime të ndryshme të financimit, pra Rruga e Thethit është në projektin që do të financohet nga BERZH-i, është rreth 20 kilometra e gjatë dhe investimi fillon në fillim të vitit tjetër.

Eduard Shalsi - Investimi apo projekti?

Benet Beci – Investimi, sepse projekti është bërë.

Projekti ka mbaruar nga Qafë Thorja deri në Theth. Ne kemi ndërhyrë në pjesën e parë pjesës së rrugës, por kjo rrugë është ndërhyrja më e vështirë dhe më domethënëse për Thethin. Së bashku me këtë, bashkë me Bankën Botërore, ne presim të fillojmë edhe tri projekte të tjera, që kemi në Pogradec pjesën e rrugës anësore të Pogradecit për në Tushemisht dhe në doganë, po kështu kemi një rrugë në Fier, që lidh Semanin. Të gjitha janë ndërhyrje që hapim jo vetëm mundësinë për zhvillimin turistik, por edhe ekonomik të rajoneve ku shkon rruga. Pra, është një paketë që përfshin edhe projektin e Thethit.

Edurad Shalsi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Faleminderit!

Meqenëse ju keni një spektër gjeografik shumë të gjerë, por, njëkohësisht, edhe nga tematika, shikoj se ju po zgjeroheni goxha dhe në fokus kemi infrastrukturën dhe pikat sensitive për zhvillimin e turizmit. A mendoni se është e mundur që të përfshini edhe projekte, të cilat lidhen me rehabilitimin e zonave të dëmtuara nga pikëpamja mjedisore? Këtu kam parasysh, nisur edhe nga zonja Gjermani, e cila përmendi Krujën. Pra, në fasadën e Krujës kemi një masakër të bërë dhe të trashëguar ose të bërë edhe gjatë këtyre viteve. A është mundur që ju të akordoni projekte për rehabilitimin e tyre në bashkëpunim me investitorët vendas?

Benet Beci – Faleminderit!

Nga ana institucionale kemi një sensibilitet të lartë të pjesës mjedisore dhe e gjej me vend ndërhyrjen tuaj. Kemi bërë disa ndërhyrje afër autostradës te Liqeni Artificial, njëkohësisht kemi bërë gjelbërime në zona të ndryshme me projekte të veçanta. Përgjigja është po, ne na takon dhe kemi mundësi që të përfshihemi në projekte me ndjeshmëri të lartë mjedisore dhe të drejtpërdrejtë në zonat që janë. Besoj se kjo duhet të jetë një çështje, që duhet të përfshihet në programet e dedikuara. Përveç këtyre që kemi, ndoshta mund të kemi nevojë të aplikojmë te donatorët edhe për programe më specifike për zona të caktuara më e ndjeshmëri të lartë. Në këtë moment nuk kemi një projekt specifik për këtë gjë, por mund të jetë një gjë, që duhet të diskutohet dhe ndoshta të përgatitet.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Leka!

Edmond Leka – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Beci për informacionin që na jepni për investimet në të gjithë Shqipërinë! Unë interesohem për zonën që mbuloj. Dihet se rruga nga Vlora në Orikum gjatë sezonit të verës ka një fluks shumë të madh dhe sivjet, me numrin e madh të turistëve që

erdhën në vendin tinë, në disa raste ishte e pakalueshme. Dua një informacion nga ana juaj, por edhe për interesin e qytetarëve dhe të banorëve të zonës: çfarë është parashikuar për vazhdimin e shëtitorës nga Vlora në Orikum?

Së dyti, çfarë u bë me investimin e rrugës nga Orikumi në Dukat dhe në bregdet?

Faleminderit!

Benet Beci – Faleminderit!

Në fakt, buxheti ka aq shumë projekte dhe detaje, ju i keni përpara, saqë do të duhej shumë kohë për t'i pasur të gjitha.

Ai është një nga segmentet më të rëndësishme për sa i përket zhvillimit të turizmit, e kemi konsideruar si të tillë dhe e kemi futur në një nga prioritetet e investimit që fillon që këtë vit. Pra, pjesa e Radhimës, nga Vlora në Orikum, sot ka një nga projektet më të bukura dhe më të kombinuara mes rrugës, zhvillimit të gjithë zonës, mes shëtitorës dhe mes zhvillimit të biznesit të zonës për të cilën bëhet fjalë.

Ka përfunduar pjesa e parë e projektit të Radhimës, pra rreth 8 kilometra. Është përcaktuar fondi i financimit nga BERZH-i, rreth 20 milionë euro, që është përcaktuar për të bërë pjesën e rrugës. Njëkohësisht, është bërë edhe një takim së fundi me një pjesë të përfituesve për të parë ndjeshmërinë që ka për pjesën ku do të kalojë rruga. Pra, ne sot në këtë segment kemi hyrë seriozisht për të ndërtuar një rrugë me parametra, për të çliruar trafikun dhe për të bërë disa devijime të bajpaseve të vogla, të cilat hapin mundësitë e zhvillimit të zonave atje më shumë se ç'janë. Njëkohësisht kemi edhe një projekt të detajuar të shëtitorës për t'i dhënë mundësi dhe hapësirë turizmit në pjesën e bregdetit, midis rrugës dhe pjesës së bregut.

Eduard Shalsi – Pra, projekti Radhimë-Orikum ka përfunduar?

Benet Beci – Janë tri lote projektesh dhe aty ka përfunduar pjesa më e madhe e saj dhe pjesa më delikate.

Eduard Shalsi – Kanë përfunduar 8-kilometra?

Benet Beci – Ka përfunduar projekti, njëkohësisht kemi alokuar fondet për financim nga BERZH-i.

Eduard Shalsi – Për vitin 2019, a është gati ky segment që të financohet?

Benet Beci – Po. Nuk mund të them saktësisht se në cilin moment të vitit do të fillojë, por ne kemi avancuar shumë për të bërë një ndërhyrje në atë zonë.

Eduard Shalsi – I gjithë loti Radhimë-Orikum sa kilometra shkon?

Benet Beci – I gjithi loti është 17 kilometra, por ajo pjesa që do të bëjmë ndërhyrje reale është më e vogël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është pjesa e rrugëve nacionale.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj - Dua pak më shumë detaje për Alpet. Unë do të pyes për Alpet, pastaj ju mund të përgjigjeni, pavarësisht nga programi që e financon. Çfarë ka më konkretisht në Valbonë?

Eduard Shalsi - Urdhëroni!

Ermir Omari – Përshëndetje!

Konkretisht, qendra e turizmit në Valbonë parashikon rehabilitimin e godinës ekzistuese, që është një godinë e vjetër, ne do ta rehabilitojmë do ta kthejmë në një godinë informacioni dhe turizmi.

Benet Beci – Më fal, a mund të bëj një sqarim?

Meqenëse i doni me detaje, në Valbonë kemi investuar në dy godina, të cilat në shumë vite u lanë dhe u shkatërruan për arsye të mosmenaxhimit e të tjera me radhë. Me kërkesën e bashkisë këto dy godia, që ishin publike, por të pamenaxhuara mirë, u kërkua që t'i marrim në dorë dhe t'i rikonstruktojmë për t'i dhënë një qëllim dhe për të ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e turizmit.

Ilir Beqaj – Çfarë shprese keni që pas rindërtimit të mirëmbahen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thatë se keni investuar para disa vjetësh...

Nuk janë menaxhuar ashtu siç duhet, tani do t'i menaxhoni, do t'i dorëzoni në vitin 2020. Çfarë sigurie keni, që, pasi t'i ribëni, nuk do të fillojë përsëri një proces degradimi?

Benet Beci – Kohët kanë ndryshuar dhe përqaqja jonë ka ndryshuar. Në fillim investimet ishin për pushtetin vendor dhe ia kishin lënë pushtetit vendor që t'i menaxhonte dhe t'i përdorte si zyrë informacioni. Ideja ishte të gjeneronte interes për zonën ky investim publik i mirëmbajtur. Pra, aty kishte internet, muze, shitje dyqane dhe pak hoteleri për rastet të veçanta. Ideja ishte të krijonim një model të zhvillimit, këtu flasim për shumë vite më arë, i cili, në menaxhimin e komunës së asaj kohe me të gjithë përpjekjet ishte një model që nuk mund të bëhej më. Tani për të mos i lënë gjërat që të degradoheshin më tepër, sepse janë edhe në bashkëpunim me bashkinë, ne si institucion morëm përsipër të rishikonim edhe një herë mundësinë e riaktivizimit të këtyre, që investimi të mos shkonte kot, por me një koncept tjetër edhe për sa i përket planit të menaxhimit.

Në studimin e Alpeve një nga komponentët e studimit ka qenë mënyra se si do të menaxhojmë, dhe kjo është bërë nga një kompani serioze, dhe kjo është një avantazhet që ka

vetë koncepti i studimit të Alpeve, sepse nuk jep vetëm çfarë do të bësh në investim, por, njëkohësisht, edhe disa modele të mënyrës se si mund të gjenerojmë biznesin e turizmit në zonë. Në këtë funksion është përgatitur plani i menaxhimit, që është shumë profesional, të cilin, në bashkëpunim me bashkinë do ta marrim vetë deri në momentin e sigurimit që kjo qendër do të funksionojë. Kjo së bashku me investimet e zonave, që përmendi zoti Ermir, të sheshit dhe të disa ndërhyrjeve të tjera, në konceptin e itinerareve turistike (se si do të lidhet nga Valbona, si do të shkohet në Theth, në Vermosh dhe në Tamarë e të tjera më radhë), jep mundësi që ky zinxhir i krijuar të kapen pikat. Thamë do të kapim Vermoshin, do të shkojmë me rrugë deri në Theth, nuk e kemi vendosur mund të bëjmë dhe ndërhyrjen e Thethit, por itinerari funksionon, me produkt turistik dhe me ofertë turistike specifike, si dhe me disa investime dhe me një menaxhim të mundshëm që të ketë kuptim. Po ta shikosh si numër, nuk janë shumë para, pra 5 milionë euro është ndërhyrja, por zona me aq lekë mund të fillojë të bëhet shumë interesante dhe me një koncept të ri turizmi dhe jo e shpërndarë.

Ermir Omari – Në Valbonë përfshihet rehabilitimi i godinave ekzistuese, ndërtimi i 4-5 objekteve të reja, që do të shërbejnë për hoteleri, dyqan suveniresh, kuzhinë me restorant, fushë basketbolli, parkim, një miniklinikë për vendin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një qendër shëndetësore, të cilën do ta rehabilitojmë.

Ilir Beqaj - Thatë: Qafë Thore-Theth 20 kilometra, a do të shkoni deri në Breg të Lumit apo deri në Theth?

Ermir Omari – Deri në Theth, pjesën e Bregun të Lumit nuk e kemi përfshirë. Nuk është përfshirë, sepse mund të kemi debate për ndjeshmërinë mjedisore dhe do ta shikojmë në një moment të dytë, por kjo është parashikuar në pjesën e parë.

Ilir Beqaj – Atëherë, duke ndenjur këtu, do t'ju sugjeroja të merrnit në konsideratë që nga Thethi-Bregu i Lumit të vinit në Prekal, për të ardhur tek ura e Mesit.

Eduard Shalsi – Të lutem, edhe një herë!

Ilir Beqaj – Po ta marrësh në mënyrë të plotë, ka dy mënyra se si të shkohet në Theth, pra dilet në Koplik, afër Razmës, hipën në Qafë Thore dhe zbret në Theth, por ka edhe një mënyrë tjetër, që t'i vjen te ura e Mesit, nuk e kalon urën e Mesit për të shkuar në Drisht, por futesh lart dhe del në Prekal. Pse e them këtë?! Unë besoj se mund të ndërtohet një ofertë shumë interesante turistike bazuar në mënyrën se si ka funksionuar dikur bajraqet, sepse janë shumë interesante për shumë vizitorë të huaj, por edhe për brezin e ri shqiptar për të njohur si ka qenë e organizuar në bajraqe funksionimi i Shqipërisë në atë kohë. Një tjetër gjë shumë interesante mund të jetë, sepse ajo në shekullin e XVIII ka qenë abaci, dhe mund të

gjenerojë një turizëm me dimensione religjioze jashtëzakonisht interesant. Sigurisht, nuk mund të bëhet me skaotista. që marrim çantën e të tjera. Ky është sugjerim.

Sugjerimi i dytë që kam (ne bashkë kemi biseduar kur vjen fjala për atë pjesë) është bregu verior i liqenit të Komanit, sepse ndarjen natyrale të Alpeve na e bën liqeni i Komanit. Sigurisht, liqeni ka një specifikë të veçantë që, sipas stinëve, i lëviz shumë pasqyra ujore, ne këtë siklet e kemi edhe në Ulzë, sepse ajo lëviz 7-8 metra, por besoj se pjesa e lundrueshme është shumë më interesante, aq sa sot pjesa e lumit të Shalës krahasohet me të gjithë bukuritë e Tajlandës. Domethënë, po të shikosh bukuritë, duket sikur je në vendet e Azisë së largët. Mendoj se me këto ndërhyrje, me shtigjet dhe me gjurmimin dhe me investime jo shumë të mëdha, mund të arrini të zgjeroni konceptin e Alpeve. E kam sugjerim, pastaj ju i dini vetë ato punë.

Tani kalojmë pak te projekti i Bankës Botërore.

Eduard Shalsi – Të bëj një koment me këto dy sugjerime?

Për shembull, a i keni menduar, sepse kam përshtypjen se kanë qenë edhe pjesë e debatit.

Benet Beci – Sigurisht, mënyra se si përqasemi është shumë e drejtë. Pra, për t'i hyrë Thethit nga Bregu i Lumit Poshtë, nga Prekali, dhe për të ardhur nga sipër, sepse ka qenë një debat nga mund të ndërhyhet më mirë, apo më lirë, është e mundur. Zgjidhja strategjike që kemi bërë, është se ne kemi shkuar deri në Prekël me investimet që ka pasur trafikun dhe banorë më shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aksi i poshtëm është aks shumë interesant, por për sa i përket pjesës së financimit, ju e dini që bëhet me prioritet. Këtë do të bëjë më parë dhe këtë më vonë, në bazë të impaktit. Sigurisht, aty është një sasi shumë interesante, por për sa i përket momentit të kostos për përfitim, ndoshta nuk ishim në një gjendjen të bëjmë dy rrugë për të kapur Thethin, një nga Prekali poshtë dhe një nga lart. Kështu që u vendos të bëjmë vetëm pjesën e sipërme, që është rruga më tipike e saj, ndërsa pjesa e poshtme u la të shkojë deri në Prekal për arsye të impaktit që të kemi më shumë njerëz. Lidhja është e mundur të bëhet, sot ne kemi një projekt të gatshëm për këtë që ju thoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk jam i sigurt, sepse ajo ka qenë që nga ura e Mesit deri lart duhet të ketë qenë rreth 40 kilometra, rreth 35 kilometra, kështu që 15 kilometra është deri në Prekal, që është mbaruar, por mund të jetë 25 kilometra, por është me përafërsi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Theth-Bregu i Lumit realisht nuk ka nevojë as për rrugë, sepse ajo është aq natyrale, saqë për mendimin tonë ajo duhet parë. Ajo është me zhavorr dhe ndoshta nuk ka nevojë për rrugë dhe kur ecet duket sikur ecën në natyrë, por gjithsesi është diçka për t'u diskutuar.

Nuk mendoj se është momenti për sa u përket parave për t'u futur në Theth me dy rrugë, ndoshta në një moment të dytë mund të kemi luksin që të futemi për të marrë maksimumin e zonës natyrale që është atje.

Ilir Beqaj – Me projektin e Bankës Botërore, çfarë segmentesh mendoni të filloni vitin e ardhshëm?

Benet Beci – Konkretisht kemi segmentin Fier-Seman, 18,2 kilometra; kemi Qafë Thor-Theth, 16 kilometra...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E gjithë rruga atje ka marrë shtresën e sipërme, por është e përkohshme. Praktikisht do të bëhet rrugë tamam, pra do të bëhet rrugë e parametrave dhe trafikut, me trotuare, me korsi biçikletash, me ndriçim e të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjerësinë e kemi 7 metra asfalt, 2,5 trotuar dhe korsi biçikletash nga Fieri në Seman mund të shkosh me biçikletë edhe në formë turistike .

Eduard Shalsi – Sa kilometra është?

Benet Beci – 18,2 kilometra.

Qafë Thorja me Thethin është 16 kilometra dhe kemi Pogradec-Tushemisht 6,25 kilometra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sistemimi i rrugës që vjen nga karburanti deri te kthesa e fortë, që është në Tushemisht, pra e gjithë rruga do të ribëhet me gjerësi urbane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në atë gjurmë, pra ajo rrugë do të bëhet komplet. Qëllimi është se e gjithë zona është pjesë e investimeve të mëtejshme, zoti kryetar e di, të ndërhyrjeve me donatorëve të tjerë për të sistemuar Tushemishtin edhe më tej. Kështu që ky është hapi i parë.

Eduard Shalsi – Pra, bëhet fjalë për rrugën paralel me të liqenit, jo rrugën e liqenit, por rrugën nga mbrapa.

Benet Beci – Ka mundësi që rruga e liqenit të mos jetë zgjidhja më e mirë, aty mund të jetë një shëtitore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pedonalen nuk e kemi ne, ajo është në diskutim.

Kjo ka rëndësi për trafikun, që t'i largohemi liqenit dhe njëkohësisht bëjmë gati pjesën e zhvillimit të Tushemishtit, e cila ka një tjetër projekt dhe mund të dalë me një unazë përreth. I gjithë qëllimi është që pjesa e liqenit të jetë sa më e pastër dhe sa më jashtë trafikut.

Eduard Shalsi – Projekti mund të shkonte përtej kthesës, në fakt, destinacioni ishte pika kufitare, por ngecëm aty, sepse te kthesa fillon edhe projekti Drilon-Tushemisht me Fondin Amerikan të Zhvillimit dhe për t'i koordinuar dhe duke pasur parasysh se çfarë konkluzioni do të nxjerrin ato, pastaj do të vijojmë ne.

Benet Beci – Këto të tria janë nga pjesa e Bankës Botërore, dhe, sipas financimit, mund të kursejmë disa fonde. Për momentin kemi mundësi të shtojmë ndonjë segment tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lura, është projekt nga BERZH-i, sepse janë dy paketa. Pra, është një paketë e BERZH-it bashkë me Bankën e Botërore, që do të ketë Velipojën, Shëngjinin dhe Radhimën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Velipojë-Shëngjin është te Rana e Hedhun sipër.

Eduard Shalsi – Rruga e re?

Benet Beci – Po rruga e re, që e ka BERZH-i, por është brenda një pakete, pra Banka me BERZH-in kanë bërë 100 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është rreth 13 kilometra, nga porti i Shëngjinit deri në Rrjollë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Torovicë do të kemi një ndërhyrje tjetër me fondet e qeverisë shqiptare për të sistemuar të gjithë pjesën e fshatrave. BERZH-i ka edhe aksin që lidh Tepelenën, nëpërmjet Nivicës, dhe del në Kuç. I gjithë aksi, që e lidh investimin e rrugës së Lumit të Vlorës me pjesën e brendshme të Shqipërisë për të dalë jashtë, mund të jetë një kombinim në kohë i dy projekteve madhore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më urën e Lumit të Vlorës lidhet diku te burimet e ujit të Kuçit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo vjen nga Nivica. Është një rrugë e re në krah të lumit, e cila duhet të jetë diku 7 kilometra. Është një segment që nuk ka rrugë.

Ilir Beqaj – Të paktën në nivel studimi fizibiliteti na jepni një sugjerim se ku të adresohemi për të dalë nga Tirana, nga Paskuqani, direkt në Krujë.

Benet Beci – Në qoftë se mendoni si aks, se varet në çfarë kategori rruge mund të futet. Pra po thoni një rrugë që të lidhë Tiranën drejtpërdrejt me Krujën?

Ilir Beqaj – Po.

Benet Beci – Në rregull. Mendova se po thoshit si një aks lidhës.

Ilir Beqaj – Unë besoj se kjo pjesa këtej sado të rregullohet, do të jetë gjithmonë e ngarkuar se aty lëvizin të gjithë shqiptarët. Domethënë, nga Qafë Kashari deri në Fushë Krujë lëvizin dhe bëhen kaçurrel 7 milionë shqipfolës. Kështu që zgjerimi i ofertës turistike të Tiranës dhe Krujës, rritja e kërkesës për Krujën me një rrugë që në vijë ajrore nuk është më shumë se 15 kilometra.

(Diskutime pa mikrofon)

Benet Beci – Kjo iniciohet normalisht nga bashkia. Sigurisht, mund ta iniciojmë edhe ne...

Ilir Beqaj – Janë dy bashki. Ka edhe një specifikë që e bën pak më të vështirë, u përket dy qarqeve të ndryshme dhe dy rajoneve të ndryshme. Pra, kjo e bën më të vështirë se kush do ta marrë lidhshkrimin për ta bërë. E them këtë sepse kam edhe shqetësimin e Burrelit. Po dola në Krujë, dal në Qafështamë dhe shkoj në Burrel. Me Rrugën e Arbrit Burreli mbetet si Puka. Siç e nxori Rruga e Kombit Pukën si xhep të vogël, edhe Burreli ashtu do të mbetet vetvetiu. Kështu, përderisa ne kemi bërë një investim në Qafështamë...

(Reagime pa mikrofon)

Domethënë, dalja në Burrel nëpërmjet këtij aksi bëhet jo e vështirë. Unë ngul këmbë që rruga Tiranë-Krujë shkurt duhet bërë jo nga Burreli, por direkt Krujë-Tiranë. Çfarë ofron vetë Kruja?

(Diskutime pa mikrofon)

Pastaj kryqëzohen dy qarqe dhe dy rajone të Shqipërisë.

(Reagim pa mikrofon)

Studimin e fizibilitetit a mund ta filloni ju, apo nuk keni tagër dhe duhet t'i themi dikujt tjetër?

Benet Beci – Ne mund ta fillojmë nëse do ta iniciojë dikush.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Zonja Piro.

Tatjana Piro – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Beci!

Unë dua të flas për Lushnjën. Lushnja, si të gjitha qytetet e tjera, ka mangësitë e saj. Por sot do të flas për një rrugë kryesore, që është rruga “Sabri Kosturi”, e cila lidh dy pjesë të qytetit. Në planin urban është përcaktuar një nga arteret kryesore të këtij qyteti...

Eduard Shalsi – Cilën rrugë lidh që ta kuptojmë edhe ne?

Tatjana Piro – Lidh qytetin me autostradën.

Është një sipërfaqe e madhe toke që ka qenë pjesë e fermave...

Eduard Shalsi – Qyteti me autostradë nuk lidhet nëpërmjet rrugës që është bërë me palma?

Tatjana Piro – Jo me autostradën, por me rrugën kryesore. Kjo është rrugë tjetër. Është një parcelë e madhe që ka qenë në fermat që janë dhënë me ligjin nr. 7501 dhe janë kthyer në troje, ku janë rreth 200 vila të vogla dy-tri katërshe, shumë pak janë njëkatëshe.

Eduard Shalsi – Sa kilometra është?

Tatjana Piro – Është 1,2 kilometra. Kjo infrastrukturë u sjell banorëve lehtësi shumë të mëdha. Atje ka edhe një pjesë tjetër, që është shumë problematike, sepse përveç rrugës, pa bërë janë edhe kanalet e ujërave te zeza.

Eduard Shalsi – Është rrugë qyteti?

Tatjana Piro – Është lagje qyteti.

Eduard Shalsi – Bashkia a ka bërë ndonjë gjë?

Tatjana Piro – Jo, bashkia nuk ka mundësi ta bëjë atë.

Tjetra është vazhdimi i pjesës së dytë të lagjes “Xhevdet Nepravishta”. Pra, është bërë një pjesë, kurse tjetra është e pabërë. Në dijeninë time, këto projekte duhet të kenë ardhur edhe te ju, edhe te ministria përkatëse. Inshalla jeni ju ai që do të vërë gurin e parë!

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Kjo pjesa e parë, pra “Xhevdet Nepravishtës” që sapo u tha nga zonja Piro, është financuar nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve ka kaluar te ju? Bashkitë duhet të konkurrojnë? Për shembull, është bërë loti i parë, po i dyti? Normalisht, duhet të vazhdojë me rrjedhë logjike...

Benet Beci – Ekzaktësisht atë desha të thosha. Tani ajo do të hyjë në sistemin e vlerësimit. E mora shënim atë që tha zonja Piro. Ne do ta shikojmë këtë si pjesë e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Për vazhdimin e saj do të bëhet një vlerësim, pra do të futet në sistemin tonë të vlerësimit. Shpresoj të jetë te pjesa e investimeve që mund të dalë me prioritet

(Reagim pa mikrofon)

Ne e mbajtëm shënim komentin tuaj dhe do t'ju japim një përgjigje të drejtpërdrejtë pas dy ditëve, pastaj do të shikojmë se çfarë mund të bëjmë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Bici.

Dritan Bici – Unë dua ta falënderoj Fondin e Zhvillimit, sepse kemi pasur një bashkëpunimin të hershëm me të për realizimin e shumë projekteve! Ajo që bën Fondi i Zhvillimit, në krahasim me të tjerët, është se projektet kanë qenë kualitative, në kuptimin që janë realizuar më mirë se sa projektet që kanë realizuar qeveritë shqiptare, kjo për shkak edhe të monitorimit të të huajve pranë këtij Fondi.

Dua të flas për Gramshin, si deputet i tij zyrtarisht njihet Anastas Angjeli, por unë si deputet i rastësishëm më dhemb pak më shumë se jam nga Gramshi. Dua të them se rrethi i Gramshit, krahasuar me të gjitha rrethet e tjera të Shqipërisë, trashëgon një infrastrukturë shumë miserable nga e kaluara. Në qoftë se rrethet e tjera fqinjë, si Korça, Librazhdi apo edhe të tjera, kanë trashëguar nga monizmi një rrejt infrastrukturor më të mirë, Gramshit, shyqyr Zotit, në sajë të realizimit të projektit të “Devolli Hydropower” iu normalizua rruga, por rruga që lidh qytetin e Gramshit me ish-qendrat e komunave lë shumë për të dëshiruar. Edhe me ministrin kemi debatuar dhe ai ka thënë se është një gjë shumë e vështirë për t’u realizuar, sepse afërisht të gjitha ish-qendrat e komunave janë në largësi 30 kilometra. Duhet shumë investime. Me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve është futur ujëvara e Sotirës, pra këto “100 fshatrat”. Unë për veten time kam rezerva, sepse bëhet një rrugë për një përrua, ku nuk ka asnjë investim nga privatët. Faktikisht ajo është shumë e vizituar, por nuk ka asnjë lloj investimi nga privatët që njerëzit të rrinë atje, pra të ketë një hotel apo diçka tjetër. Ndërkohë, lihen zona si Grabova e Sipërme ku ka investime nga privatët, por që ka edhe histori të vjetër, sepse ai është një fshat ortodoks, të cilët nuk votuan në zgjedhjet e fundit parlamentare vetëm, sepse e quajnë veten të diskriminuar. Unë nuk jam ortodoks, por mysliman. Ata quhen vllah dhe kanë tradita të vjetra për sa i përket të drurit dhe leshit dhe kanë lidhje me Voskopojën, me Llëngën e Pogradecit. Unë për vete në fund fare nuk mbaj përgjegjësi për Gramshin, se është Anastasi dhe nuk e di se çfarë muhabetesh ka bërë ai me ju lidhur me këto, po sikur një rrugë në vit të bëhej, diçka do të ishte bërë! Qendrat e ish-komunave është shumë gjynah të lihen në këtë situatë.

Unë si Dritan do të vij për rrugën e fshatit tim. Për këto të tjerat le të vijë Anastasi. Unë dua që, brenda vitit 2019, të më ndihmosh se çfarë projekti duhet bërë, çfarë studimi duhet të bëhet, pra për vitin 2020 e kam zënë radhën të futet në projekt.

Edhe një herë, të falënderoj për punën e bërë! Ju kam ndjekur që herët kur kam qenë kryetar komune dhe kam bashkëpunuar me ju, duke marrë shumë fonde nga BERZH-i, nga Banka Botërore dhe nga Banka Islamike, të cilët kanë qenë shumë aktivë për sa u përket fondeve. Shikoj se jeni në rrugën e duhur. Suksese!

Eduard Shalsi – Jemi në mbyllje...

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Meqenëse folëm për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, sa thirrje do të ketë vit dhe ku do të jetë fokusi që edhe ne t'i nxitim, t'i informoja dhe t'i inkurajojmë bashkitë? Pra, të jemi bashkë me ju për të lobuar që të aplikojnë për projektet tuaja që ta dinë në cilat fusha dhe sa është fondi i parashikuar për to.

Eduard Shalsi – Vazhdon ekziston fondi, apo është shkrirë brenda strukturave tuaja? Si funksionon nga pikëpamja organizative?

Benet Beci – Është përfshirë te fondet tona, por ne sapo të kemi një procedurë, do të mundohemi ta shpallim sa më shpjet. Pra, do t'u vëmë në dijeni në kohën e duhur për të qenë sa më transparente që t'i paraprijmë investimit. Në këtë moment nuk e kemi mënyrën e thirrjes dhe se si do të operojmë. Është kaluar e gjitha të Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Eduard Shalsi – Do të vazhdojë të ekzistojë si strukturë, apo do të jetë e shkrirë brenda fondit, apo është ende duke u debatuar?

Benet Beci – Edhe këtë vit do të vazhdojë, pastaj masa se si do të jetë, do të caktohet, por në koncept do të vazhdojë.

Eduard Shalsi – Nuk ka logjikë si strukturë, duhet të shkrihet normalisht. Pra, deri në shkrirje, po mbahet për çështje bilanci.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, para se ta mbyll, dua të shpreh vetëm një merak timin në lidhje me projektin “100 fshatrat”, me domosdoshmërinë e koordinimit të disa institucioneve, sikundër pata edhe takimin me Fondin Amerikan të Zhvillimit. Për shkak të kompleksitetit të ndërhyrjeve është shumë e domosdoshme një rakordim midis të gjithë aktorëve që janë duke u marrë. Në rastin konkret, për zonën Drilon-Tushemisht besoj se është lidhur kontrata, është përzgjedhur kompania e cila do të bëjë projektin. Në fakt, kishte një konkurrencë të jashtëzakonshme. Fituese ka dalë një kompani nga Portugalia, por e shoh të domosdoshëm bashkëpunimin e disa institucioneve për finalizimin e disa projekteve.

Për projektin “100 fshatrat” ne do të kemi një dëgjues në komision, sepse është shumë e rëndësishme që projekti të mos shikohet thjesht si një projekt urbanistik, por të shihet si ndërthurje e shumë komponentëve për të zhvilluar zonën. Në qoftë se keni ndonjë

merak nga pikëpamja institucionale, nga pikëpamja e bashkëpunimit dhe e ndryshimeve ligjore, jemi të gatshëm të ndihmojmë çdolloj iniciative që mund t'i koordinojë palët, që ekziston në fakt, por duam të jetë në mënyrë më efektive.

Benet Beci – Kryetar, në fakt, unë dua t'ju falënderoj! Ky është një nga komisionet me të cilin ne kemi pasur bashkëpunim edhe për shkak të natyrës së komisionit, por edhe për mënyrën sesi ju e keni organizuar për të shkëmbyer informacione dhe për ta përmirësuar punën tonë në bazë të komenteve.

Pika që ju përmendët është vërtet një pikë kyçe në suksesin dhe zhvillimin e projektit “100 fshatrat”. Megjithatë projektet tona të huaja janë në implementim, duhet t'i shohim ato edhe nga këndvështrimi i “100 fshatrave” për t'i përshtatur në funksion të tyre. Njëkohësisht, e shoh shumë me vend pjesën e koordinimit ndërinstitutional, sepse do ta maksimizonte shumë dhe do ta bënte shumë më të prekshëm rezultatin e projektit.

Ju faleminderit shumë!

Eduard Shalsi – Duke ju falënderuar, ju uroj një vit të mbarë!

Bashkë, të nderuar kolegë deputetë, do të shihemi për 45 minuta me intensitetin e vijimit të diskutimeve për buxhetin dhe për paketën fiskale, sepse kemi të ftuar shumë aktorë të tjerë.

Ju faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA